



www.legjisllacioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 19

Tiranë – E hënë, 13 qershor 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3678, datë 21.4.2016	Me objekt hapjen e procedurës së falimentit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., regjistruar si person juridik me NUIS J61827030N, me seli në adresën: sheshi “Avni Rustemi”, pallati “Teuta Construction”, kati 1, Tiranë, Shqipëri, për shkak të gjendjes së paaftësisë paguese.....	3
Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 8222, datë 9.6.2016	Njoftim për shitje.....	9



VENDIM

Nr. 3678 akti, datë 21.4.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË, E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: FATRI ISLAMAJ

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Bora Buka**, sot në datën 21.4.2016, përfundoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile nr. 3678 Akti, që i përket:

KËRKUES: **Shoqëria “HAVAŞ – HAVAALANLARI YER HIZMETLERI A.Ş.” sh.p.k.**, shoqëria anonime e së drejtës turke, e regjistruar si person juridik me numër fiskal 4590036800 me seli në adresën: Ataturk Havalimani Dis Hatlar Terminali 34149 Yesikloy, Stamboll Turqi, përfaqësuar me prokurë të posaçme, datë 20.1.2014, nga av. Dorand Ekmeçi dhe av. Jori Bregasi, anëtarë të zyrës së avokatisë “Hoxha, Memi & Hoxha” sh.p.k., me seli në adresën: rr. “Nikolla Tupe”, nr. 5, ap. 1, Tiranë – Shqipëri.

PERSONA TË TRETË: **Shoqëria “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k.**, regjistruar si person juridik me nr. NUIS J61827030N, me administrator z. Yahia Farëati, me seli në adresën: sheshi “Avni Rustemi”, pallati “Teuta Construction”, kati 1 Tiranë, Shqipëri (*në mungesë*).

Shoqëria “TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT” (TIA), person juridik shqiptar, regjistruar me vendim nr. 32147, datë 20.9.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NUIS K51612012D, me seli në adresën: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, ndërtesa e administratës, Rinas, Shqipëri, përfaqësuar me autorizimin e datës 15.1.2016, nga z. Ardit Loloci.

OBJEKTI: Hapja e procedurës së falimentit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., regjistruar si person juridik me NUIS J61827030N, me seli në adresën: sheshi “Avni Rustemi”, pallati “Teuta Construction”, kati 1, Tiranë, Shqipëri, për shkak të gjendjes së paaftësisë paguese.

BAZA LIGJORE: Nenet 334 e vijues të K.Pr.Civile; nenet 11, 13, 14 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, si më lart, pasi:

Dëgjoi:

Palën kërkuese, shoqëria “HAVAŞ – HAVAALANLARI YER HIZMETLERI A.Ş” **sh.p.k.**, përfaqësuar nga av. Dorand Ekmeçi, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit;

Personi i tretë: Tirana International Airport, përfaqësuar nga juristi av. Ardit Loloci, i cili u shpreh dakord për hapjen e procedurës së falimentit.

Në mungesë të personit të tretë, shoqëria “Albanian Airlines” sh.p.k.

Ia nënshtroi hetimit gjyqësor dhe çmoi provat e paraqitura;

shqyrtoi çështjen në tërësi;

VËREN:

1. Me kërkesën drejtuar kësaj Gjykate, pala kërkuese kërkon hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultoi se:

2. Shoqëria “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k. është një shoqëri tregtare e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë, në datë 16.5.1995. Kjo shoqëri ushtron aktivitetin tregtar në fushën e transportit ajror të mallrave e të pasagjerëve me mjetet e transportit ajror të blera prej saj, si dhe të marra ose të dhëna me qira të tyre, veprimtari të agjencisë së udhëtimit të shitjes së biletave, aktivitet magazinues e speditacioner, si dhe administrim e operim e akomodim i pasurive të paluajtshme në aeroporte që i shërbejnë kësaj veprimtarie, veprimtari riparuese, pastruese e magazinuese avionësh ose pajisje të tyre. Veprimtari Catering-u (përgatitja dhe furnizimi me ushqime dhe pije) dhe/ose ajo e Self Catering-ut (vetëfurnizim).

3. Gjatë gjykimit u provua që mes palëve ndërgjyqëse ka ekzistuar një marrëdhënie juridike detyrimi, e cila buron prej “Kontratës së shërbimeve të përpunimit në tokë”. Në këtë kontratë është parashikuar se kërkuesi do të kryente në llogari të personit të tretë të gjitha shërbimet që vijnë, por pa u kufizuar në: përpunimin e bagazheve; përpunimin e avionit në vendqëndrim; furnizimin me karburant dhe vajra; për-



punimin fizik të mallrave dhe të postës në mbërritje, nisje ose transit, në zonën nga terminali deri në avion etj.

Rezulton se personi i tretë, nuk kishte shlyer në kohë një pjesë të faturave të kërkuesit për shërbimet e kryera në bazë të kontratës së sipërcituar, dhe këto fatura, me vlerë të përgjithshme prej 156,439.80 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë centë), nuk ishin kundërshtuar nga personi i tretë për asnjë shkak.

4. Në datën 6.3.2014, kërkuesi iu drejtua Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën për çeljen e procedurës së falimentit ndaj personit të tretë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., në datën 9.6.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konfrom nenit 18 të ligjit “Për falimentin”, i ndryshuar, vendosi të caktojë një eksperte me njohuri në fushë, për të paraqitur të dhënat e nevojshme për ndjekjen e procedurave të falimentit. Në datën 22.7.2014, ekspertja e caktuar në cilësinë e administratorit të përkohshëm të falimentit, duke vlerësuar gjendjen e renduar financiare të debitorit, personit të tretë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., kërkoi marrjen e masës së sigurimit ndaj pasurisë së tij. Me vendimin nr. akti 8915, datë 30.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mori një sërë masash ndaj debitorit, personit të tretë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., me qëllim sigurimin e masës së falimentit. Në datën 22.9.2014 midis kërkuesit dhe debitorit, personi i tretë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., u lidh marrëveshja për ristrukturimin e detyrimit. Kërkuesi, në datën 30.9.2014 hoqi dorë nga gjykimi dhe Gjykata, me vendimin nr.9432, datë 1.10.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendosi pushimin e çështjes.

5. Në bazë të marrëveshjes për ristrukturimin e detyrimit midis kërkuesit dhe debitorit, personi i tretë, shoqëria “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., është rënë dakord që shoqëria do t'i paguante kërkuesit shumën prej euro 62,000 (gjashtë dhjetë e dy mijë euro) brenda datës 23 shtator 2014, ndërsa diferenca në shumën prej euro 94,439.80 (nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë centë) do të shlyhej nga shoqëria “ALBANIAN AIRLINES”, sipas përcaktimit në marrëveshje. Rezulton se kërkuesi nuk ka rinisur operacionet

duke lidhur me kërkuesin marrëveshjen përkatëse për shërbimet e përpunimit në tokë.

6. Në këto kushte, kërkuesit i ka lindur e drejta që t'i kërkojë shoqërisë “ALBANIA AIRLINES” sh.p.k. shlyerjen e të gjithë vlerës së mbetur të kredisë, prej euro 94,439.80 nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë centë). Kërkuesi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me debitorin, në datën 14.10.2015, ka drejtuar një shkresë debitorit, personit të tretë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., duke i shlyer detyrimin deri në datën 23.10.2015, dhe duke e njoftuar që nëse detyrimi nuk shlyhet deri në këtë datë, kërkuesi do të nisë procedurat ligjore për shlyerjen e detyrimit dhe kamatëvonesave.

6. Pala kërkuese, shoqëria “HAVAŞ – HAVAALANLARI YER HIZMETLERI A.Ş” sh.p.k., duke i referuar ekstraktit historik të lëshuar nga QKR-ja rezulton se shoqëria “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., është debitor edhe i disa palëve të treta, vërtetimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se ndaj debitorit janë ngritur disa kërkesëpadi nga palët e treta për pagimin e detyrimeve të mëdha, dhe në kushtet kur nuk e shtron me aktivitetin, pretendon se shoqëria “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., nuk ka aftësi paguese.

Pala kërkuese, shoqëria “HAVAŞ – HAVAALANLARI YER HIZMETLERI A.Ş”, me cilësinë e kreditorit i është drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për hapjen e procedurës së falimentimit.

Në lidhje me parashikimet ligjore në përputhje me rastin konkret, Gjykata vëren se:

7. Neni 13 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon: “1. *Procedura e falimentimit për vetëm me shkak. 2. Gjendja e paaftësisë paguese përbën shkak të përgjithshëm për hapjen e procedurës së falimentimit. Debitori vlerësohet i paafte për të paguar nëse nuk është në gjendje të paguajë detyrimet në datën e maturimit. Paaftësia paguese prezumohet se ekziston nëse debitori nuk kryhen pagesat... 4. Mbingarkesa me borxhe përbën shkak për hapjen e procedurës së falimentimit në rastin e një personi juridik. Debitori ndodhet në gjendjen e mbingarkesës me borxhe kur vërtetohet se pasuritë e tij nuk mbulojnë detyrimet ndaj të tretëve dhe në bazë të rrethanave pas*



vlerësimit të pasurive të debitorit nuk është me mundësia për vazhdimësinë e veprimtarisë...”.

8. Neni 14/1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm **me kërkesën** e debitorit ose **kreditorëve**. Në rastin e personave juridikë, procedura e falimentimit mund të hapet edhe me kërkesën e organeve tatimore kur rezulton një bilanc me humbje për një periudhë trevjeçare...”.

9. Në nenin 17 të ligjit parashikohet dhe legjitimimi aktiv i kreditorit për të kërkuar hapjen e procedurës së falimentimit. Kështu, në këtë dispozitë parashikohet: “1. Kërkesa e kreditorit pranohet nga seksioni tregtar i gjykatës së rrethit, kur ai ka një interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit, kur paraqet kërkesën sipas ligjit dhe nëse Gjykata çmon se shkaqet për hapjen e procedurës së falimentimit janë të mjaftueshme dhe bindëse për të. Vlerësohen se kanë interes të ligjshëm për hapjen e procedurës së falimentimit kreditori, i cili ka ndaj pasurisë së debitorit një interes me karakter pasuror dhe autoritetet fiskale. Shkakut për hapjen e procedurës së falimentimit prezumohet se ekziston nëse debitori, pavarësisht se nuk e ka kundërshtuar pretendimin, nuk e ka shlyer këtë detyrim tre muaj pas datës së maturimit të pagesës. 2. Nëse kërkesa e kreditorit pranohet, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit thërret dhe dëgjon pretendimet e debitorit.”.

10. Neni 18/4 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon: “Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit brenda afateve të treguara në pikën 3 të këtij neni vendos: c) **pranimin e kërkesës dhe hapjen e procedurave të falimentimit**”.

11. Neni 26 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon: “1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos hapjen e procedurës së falimentimit kur **çmon se janë shkaqet dhe kushtet** e parashikuara në këtë ligj për hapjen e procedurës së falimentimit. 2. Vendimi për hapjen e procedurës së falimentimit, përmban: a) emrin, mbiemrin dhe vendbanimin e debitorit në rastin e personave ose emrin, llojin e veprimtarisë dhe selinë në rastin e personave juridikë; b) emrin, mbiemrin dhe adresën e administratorit të falimentimit; c) orën e saktë kur është hapur procedura e falimentimit; ç) të dhënat e parashikuara në nenet 27 dhe 29 të këtij ligji; d) urdhërimin e detyrimit të publikimit të vendimit në internet, në faqen zyrtare të gjykatës, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe të organit tatimor

përkatës... 4. Së bashku me hapjen e procedurës së falimentimit, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit vendos emërimin e administratorit të falimentimit”.

12. Në përfundim pas analizës së faktit, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse dhe analizës së parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, ajo duhet të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët.

13. Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohej se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët ose krijimin e një plani shëndetësimi për këtë subjekt, në rast se arrihet në përfundimin se një veprim i tillë është i mundur.

14. Fillimi, në rrugë gjyqësore, i procedurës së falimentimit realizohet vetëm në kushtet e ekzistencës së shkakut të falimentimit:

a) gjendje e paaftësisë paguese të subjektit që i drejtohet kërkesa për falimentim; ose/dhe

b) mbingarkesës së subjektit me borxhe.

15. Legjitimimin aktiv për fillimin e procedurave gjyqësore të falimentimit, e gëzon kreditori, debitori, si dhe organet tatimore, në rast konstataimi të humbjeve në bilanc të subjektit për një periudhë fiskale trevjeçare. Në rastet kur kërkesa për hapjen e procedurave të falimentimit paraqitet nga vetë subjekti debitor, ky i fundit duhet t'i evidentojë gjykatës listën e pasurive dhe të ardhurave, listën e kreditorëve me vlerat respektive të detyrimit. Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, Gjykata arrin në përfundimin se pala kërkuese legjitimohet të paraqesë këtë kërkesë, pasi ka cilësinë e kreditorit në procedurën e falimentimit dhe ndaj pasurisë së debitorit vlerësohet se ka një interes me karakter pasuror.

16. Në zbatim të parashikimeve të nenit 18 të ligjit, me qëllim për të hetuar rreth pretendimeve të kërkuarit për ekzistencën e gjendjes së falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., Gjykata emëroi si administratore të përkohshme të falimentimit znj. Shpresa Breçani, së cilës iu caktuar si detyrë të verifikojë ekzistencën e shkakut/shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, në drejtim të gjendjes



së paaftësisë paguese të subjektit apo/dhe mbingarkesës së tij me borxhe, të verifikojë nëse pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit, të verifikojë nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë, si dhe mundësinë për vijimësinë e veprimtarisë tregtare të debitorit.

17. Nga raporti i paraqitur nga administratorja e përkohshme e falimentimit, rezultuan këto përfundime:

- Ekzistenca e shkakut të hapjes së procedurës së falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k. është real. Nga provat, sipas aktit, rezulton se shoqëria është në gjendjen e paaftësisë paguese, në kushtet kur ka detyrime të pashlyera në datën e maturimit të tyre (mbi tre muaj) dhe nuk ka gjendje mjetesh monetare për likuidim;

- Pasuritë e debitorit mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit;

- Debitori nuk ka mundësi të vazhdojë veprimtarinë tregtare.

18. Pasuria e shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., sipas aktit të ekspertimit dhe provave shkesore, ka pasuri për mbulimin e shpenzimeve të procedurës së falimentit, të cilat aktualisht janë vetëm 4 mjete të transportit ajror, kjo e bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria përmbarimore, si dhe Banka Intesa San Paolo. Sa i përket informacionit të marrë nga Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, rezulton se ekzistojnë të regjistruara 11 automjete, por fizikisht nuk kanë të evidentuara nga ana e ekspertës, pasi dhe nga vetë shoqëritë përmbarimore që kanë vënë urdhra sekuestroje nuk është bërë evidentimi dhe marrja në zotërim për ekzekutimin e tyre. Në këtë situatë gjendemi para faktit që aktualisht janë 4 mjete ajrore (avion civil), të cilat përbëjnë asetë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të procedurës.

19. Pasuritë e shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit. Duke përlloritur shpenzimet e procedurës së falimentimit, ku përfshihet dhe pagesa e administres së përkohshme të falimentimit, administratorja e përkohshme e falimentimit arrin në përfundimin se pasuria e shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., mbulon shpenzimet e procedurës së falimentimit.

20. Në lidhje me nevojën e marrjes së masave për sigurimin e pasurisë, administratorja e përkohshme e falimentimit ka çmuar marrjen e masës së sigurimit duke pezulluar masat e sigurisë dhe ekzekutimit në lidhje me ekzekutimin e kredisë. Në lidhje me këtë konstatim, Gjykata vëren se nga ana e ekspertit vihet në dukje nevoja për marrjes së masës për pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Nga interpretimi i dispozitave të ligjit del e qartë se me shpalljen e hapjes së procedurës së falimentimit, pasuria e debitorit që sekuestrohet nga përmbaruesi gjyqësor dhe shumatat e fituara nga shitja e pasurive, bëhen pjesë e masës së falimentimit dhe përmbaruesi gjyqësor duhet t'ia dorëzojë ato administratorit të falimentimit. (Neni 74 e vijues i ligjit.) Në këtë kuadër, Gjykata vendos një masë për sigurimin e masës së falimentimit dhe jo pezullimin e një procedure përmbarimore, e cila nuk ekziston më, me çeljen e procedurës së falimentit.

21. Në lidhje me verifikimin e mundësisë për vazhdimësinë e veprimtarisë nga debitori, në bazë të aktit të ekspertimit, u provua se shoqëria “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., është bllokuar në vijimin e aktivitetit të saj tregtar dhe nuk ka likuiditete për rifillimin e veprimtarisë së saj, sipas objektit të veprimtarisë së saj.

22. Sa më lart dhe në përfundim të hetimit gjyqësor, në kushtet kur vërtetohet ekzistenca e një prej shkaqeve të hapjes së procedurës së falimentimit, Gjykata, në bazë të neneve 18/4/c dhe 26 të ligjit “Për falimentimin”, të ndryshuar, vendos pranimin e kërkesës dhe hapjen në orën 14:00, të datës 15.12.2015, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., duke emëruar si administres të falimentimit znj. Shpresa Breçani.

23. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., të paraqesin pranë administres së falimentimit, pretendimet e tyre, brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.



24. Për efekt të publikimit të këtij vendimi, në respektim të kërkesave të ligjit “Për falimentimin”, të ndryshuar, urdhërohet:

- Publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të subjektit shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike;

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit;

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar);

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë;

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

- Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar;

- Publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;

- Publikimi dy herë i vendimit të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar, gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shqip”.

25. Bazuar në nenin 8/2, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), për kryerjen e njoftimeve dhe shpalljeve publike, sipas nenit 9 të ligjit dhe caktimin e mbledhjeve brenda afateve të parashikuara në këtë vendim, ngarkohet administratorja e falimentimit, Shpresa

Breçani. Shpenzimet në lidhje me këto veprime procedurale i ngarkohen masës së falimentimit. Si rrjedhim, një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet dhe administratores së falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., Shpresa Breçani.

26. Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, që përbëhet nga taksa mbi aktet, shpenzimet për ekspert dhe shpenzimet kancelarike dhe njoftime, bazuar në nenin 106 të Kodit të Procedurës Civile, ato janë në ngarkim të palës kërkuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata bazuar në ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar);

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit, shoqëria “HAVAŞ – HAVAALANLARI YER HIZMETLERI A. Ş” sh.p.k.

2. Hapjen në orën 14:00, të datës 21.4.2016, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., me administrator Yahia Farëati, me seli në adresën: sheshi “Avni Rustemi”, pallati “Teuta Construction”, kati 1, Tiranë, Shqipëri.

3. Emërimin si administratore të falimentimit, për shoqërinë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., të znj. Shpresa Breçani, e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, me licencën nr. 9, datë 14.10.2014, me adresë: rruga “Jordan Misja”, P. Sara El, shk. 1, ap. 1, Tiranë.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., të paraqesin pranë administratores së falimentimit, pretendimet e tyre brenda 90 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit, për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruar mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe shlyejnë ato administratores së falimentimit, znj. Shpresa Breçani.

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., për raportim, të mbahet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.



8. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., për verifikim, të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

9. Urdhërohet publikimi i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., në Buletinin e Njoftimeve Publike.

10. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i njoftohet administratores së falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., Shpresa Breçani.

11. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

12. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet zyrës qendrore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform nenit 31, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar.

13. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikës së Shqipërisë.

14. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

15. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

16. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

17. Një kopje e vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

18. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., në internet, në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

19. Urdhërohet publikimi dy herë i vendimit, të shkurtuar, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “ALBANIAN AIRLINES” sh.p.k., në dy gazeta me qarkullim kombëtar, gazeta “Panorama” dhe gazeta “Shqip”.

20. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarëve.

21. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes.

U shpall në Tiranë, sot në datën 21.4.2016.

**GJYQTAR
Fatri Islamaj**



NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE
Nr. 8222, datë 9.6.2016

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, i ndryshuar, shpall për shitje me **vam të ulur**, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenëve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					data	ora	vendi
1	Qeni “Lura”	7.5.2008	Tiranë	4 000	5.7.2016	08:30	DDPP
2	Qeni “Puma”	7.3.2008	Tiranë	4 000	5.7.2016	09:00	DDPP
3	Qeni “Vjosa”	9.12.2013	Tiranë	7 500	5.7.2016	09:30	DDPP
4	Qeni “Goldi”	24.2.2007	Tiranë	4 000	5.7.2016	10:00	DDPP
5	Qeni “Vanida”	3.12.2008	Tiranë	4 000	5.7.2016	10:30	DDPP
6	Qeni “Serena”	19.4.2015	Tiranë	10 000	5.7.2016	11:00	DDPP
7	Qeni “Sear”	23.4.2015	Tiranë	4 000	5.7.2016	11:30	DDPP
8	Qeni “Skid”	23.4.2015	Tiranë	7 500	5.7.2016	12:00	DDPP
9	Qeni “Sage”	23.4.2015	Tiranë	5 000	5.7.2016	12:30	DDPP
10	Qeni “Sana”	23.4.2015	Tiranë	7 500	5.7.2016	13:00	DDPP
11	Qeni “Saber”	23.6.2015	Tiranë	5 000	5.7.2016	13:30	DDPP
12	Qeni “Sakson”	23.6.2015	Tiranë	4 000	5.7.2016	14:00	DDPP
13	Qeni “Salsa”	23.6.2015	Tiranë	5 000	5.7.2016	14:30	DDPP
14	Qeni “Sasha”	23.6.2015	Tiranë	5 000	5.7.2016	15:00	DDPP
15	Qeni “Shera”	23.6.2015	Tiranë	7 500	5.7.2016	15:30	DDPP
16	Qeni “Sara”	23.6.2015	Tiranë	4 000	5.7.2016	16:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim** për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
- Garancinë bankare apo mandatpagesën** në original që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
- Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të kenë tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2016